



**VENDIM**  
**Nr.88 Datë 15.11.2010**

**PËR**  
**LICENSIMIN E SHOQËRISË “RUDNAP ENERGY TIRANA”**  
**SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, gërma “g”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “RUDNAP ENERGY TIRANA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

**Dhe konstatoi se:**

Aplikimi plotëson kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1)
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10)

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Liçensimin e shoqërisë “RUDNAP ENERGY TIRANA” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrik, për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**